

Zehra Saiti
Bujamin Bela

IDEFE
PUBLICATIONS



RAPORT

Raporti mes Varësisë
nga Rrjetet Sociale
dhe Ankthit Social

REPORT

01
—

www.idefe.net

IDEFE Publications | 03

Report | 01

**Raporti mes Varësisë nga Rrjetet Sociale dhe
Ankthit Social**

Editors:

Zehra Saiti

Bujamin Bela

1st Edition, Skopje 2021

ISBN:

Design:

Hafsa Sherifi Abdula

Edition-Volume:

Ajgraf Skopje, 1000

Cair-Skopje, North Macedonia

© IDEFE Publications

All rights reserved. No part of this book may be reprinted or reproduced or utilized in any form or by any electronic, mechanical or other means, without permission in writing from the publishers.

IDEFE Publications

Pushkarska No.01

Cair-Skopje

North Macedonia

Tel: +38970728470

fettahefendi.com



RAPORTI MES VARËSISË NGA RRJETET SOCIALE DHE ANKTHIT SOCIAL

Mr. Zehra Saiti
Doc. Dr. Bujamin Bela

Nëntor 2021, Shkup, Maqedonia e Veriut



AUTORËT

Mr. Zehra Saiti



Zehra Saiti u lind në vitin 1994 në Shkup. Në vitin 2017 përfundoi studimet në degën e psikologjisë në Universitetin e Tetovës. Në vitin 2021 ka magjistruar në të njejtin universitet në degën psikologji industriale dhe ka mbrojtur tezën me titull "Ekuilibri punë-familje dhe performanca e punonjësve në punë". Nga viti 2019 deri më 2021 ka ushtruar detyrën e psikologut të shkollës në shkollën e mesme profesionale "Marija Kiri Skllodovska në Shkup".

Doc. Dr. Bujamin Bela



Bujamin Bela u lind në vitin 1986 në Shkup. Në vitin 2009 përfundoi studimet në Fakultetin Ekonomik në departamentin e "Menaxhmentit" pranë Universitetit "Shën Qirili dhe Metodi". Në vitin 2013 në të njejtin Universitet, në departamentin e "MBA Menaxhmentit" mbrojtë tezën e magjistraturës me titull "Krijimi i Sistemeve të Integruara të Shpërblimeve në kompanitë e Industrisë Ushqimore". Nga viti 2014 - 2019 ka doktoruar në Universitetin e Stambollit, Turqi në departamentin e "Menaxhimit me Resurset Njerëzore" dhe ka mbrojtur disertacionin me temë: "Ndikimi i Pabarazive Pagesore mbi Intencën e Lënies së Punës me moderator, Kushtet e Punës". Nga viti 2009 - 2013 ka punuar si profesor në Shkollën Profesionale Ekonomike "Cvetan Dimov" ndërsa nga viti 2017 ligjeron në Universitetin "Nënë Tereza" në lëndët Ekonomike dhe të Menaxhmentit. Në të njejtën kohë ka marrë pjesë në shumë projekte hulumtuese, simpoziume, konferenca dhe projekte vendore dhe ndërkombëtare. Aktivist në shoqërinë civile në sferën e edukimit joformal dhe edukimin e të rinjve në orinetimin e karrierës.



RAPORTI MES VARËSISË NGA RRJETET SOCIALE DHE ANKTHIT SOCIAL



FALËNDERIME

Falënderojmë të gjithë ata të cilët morën pjesë në realizimin e këtij studimi. Fillimisht falënderojmë YTB-në për mbështetjen e projektit.

Pastaj falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit të cilët pranuan që në mënyrë vullnetare të marrin pjesë në studim duke e dhënë kontributin e tyre me plotësimin e pyetësorit. Falënderim i veçantë për profesorin Doc. Dr. Ibrahim Zejd Gerçik i cili ka ndihmuar në procesin e adaptimit të pyetësorit.

Gjithashtu, në finalizimin e pyetësorit dhe raportit kontribuan edhe: Semran Murtezani, Haxher Sulejman, Haxher Aliu, Mersie Ramadani dhe Berat Alili.

U jemi mirënjohës të gjithë atyre të cilët na kanë mbështetur qoftë edhe me mbështetje morale dhe kanë besuar në punën tonë.



PËRMBAJTJA:

HYRJE	2
I. KORNIZA TEORIKE E STUDIMIT	3
1.1. Teoritë për varësinë nga rrjetet sociale	3
1.2. Teoritë për ankthin social	4
1.3. Studime të ngjashme	4
II. METODOLOGJIA	7
2.1. Qëllimi i studimit	7
2.2. Pyetjet kërkimore	7
2.3. Hipotezat e studimit	8
2.4. Operacionalizimi i variablave	10
2.5. Popullacioni dhe mostra	11
2.6. Instrumentet matëse	11
2.7. Metodatat statistikore për përpunimin e të dhënave	11
2.8. Besueshmëria e instrumenteve matëse	12
2.9. Realizimi i hulumtimit	12
III. REZULTATE	14
3.1. Rezultatet për karakteristikat demografike	14
3.2. Paraqitja deskriptive e variablave	22
3.3. Analiza e hipotezave	24
IV. PËRFUNDIM	33
V. LITERATURA	36



LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Statistika e besueshmërisë së brendshme të instrumentit për varësinë nga rrjetet sociale	16	Tabela 15. Të dhënat përshkruese për pjesëmarrësit sipas gjinisë në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social	29
Tabela 2. Statistika e besueshmërisë së brendshme të instrumentit për ankthin social	16	Tabela 16. Testi t për krahasimin e mesatareve sipas gjinisë	29
Tabela 3. Gjinia e pjesëmarrësve	18	Tabela 17. Të dhënat përshkruese sipas grupmoshave të ndryshme në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social	30
Tabela 4. Moshë e pjesëmarrësve	19	Tabela 18. Të dhënat përshkruese sipas statusit martesor në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social	31
Tabela 5. Të dhënat për statusin martesor të pjesëmarrësve	20	Tabela 19. Të dhënat përshkruese sipas vendit të jetesës në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social	32
Tabela 6. Të dhënat për shtetin në të cilin jetojnë pjesëmarrësit	21	Tabela 20. Të dhënat përshkruese sipas nivelit të arsimit në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social	33
Tabela 7. Niveli arsimor i pjesëmarrësve	22	Tabela 21. Të dhënat përshkruese sipas statusit të punës në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social	34
Tabela 8. Statusi i punës	23	Tabela 22. Të dhënat përshkruese sipas numrit të orëve që pjesëmarrësit qëndrojnë në rrjete sociale brenda ditës në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social	35
Tabela 9. Numri i orëve në rrjetet sociale brenda një dite	24	Tabela 23. Të dhënat përshkruese sipas mjetit elektronik që përdorin pjesëmarrësit në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social	36
Tabela 10. Mjeti elektronik që e përdorin më së shumti	25		
Tabela 11. Të dhënat përshkruese për varësinë dhe ankthin të pjesëmarrësit	26		
Tabela 12. Statistika e shpërndarjes normale për varësinë nga rrjetet sociale	26		
Tabela 13. Statistika e shpërndarjes normale për ankthin social	27		
Tabela 14. Korrelacioni mes variablave kryesore	28		

LISTA E GRAFIKONËVE

Grafiku 1. Pjesëmarrja sipas gjinisë me anë të paraqitjes grafike	18
Grafiku 2. Moshë e pjesëmarrësve me anë të paraqitjes grafike	19
Grafiku 3. Statusi martesor i pjesëmarrësve me anë të paraqitjes grafike	20
Grafiku 4. Vendi i banimit të pjesëmarrësve me anë të paraqitjes grafike	21
Grafiku 5. Niveli i arsimimit të pjesëmarrësve me anë të paraqitjes grafike	22
Grafiku 6. Statusi i punës së pjesëmarrësve me anë të paraqitjes grafike	23
Grafiku 7. Qëndrimi në rrjete sociale brenda ditës me anë të paraqitjes grafike	24
Grafiku 8. Mjeti elektronik që pjesëmarrësit e përdorin më së shumti	25
Grafiku 9. Shpërndarja e variablës varësi nga rrjetet sociale	27
Grafiku 10. Shpërndarja e variablës ankthi social	28





HYRJE

Tema e këtij studimi është mjaft aktuale dhe e rëndësishme për kohën në të cilën po jetojmë. Çdo ditë e më shumë jeta jonë po digjitalizohet dhe po merr një kah tjetër. Zhvillimi i botës së digjitalizuar dhe ndikimi i saj te njeriu pa dyshim se është temë interesi për të gjitha fushat e psikologjisë, por më së shumti asaj sociale. Pyetjes së cilës synon t'i japë përgjigje ky studim është: Cila është marrëdhënia mes varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social?

Me ardhjen e medias së re, Web 2.0, pjesëmarrja e popullatës në rrjetet sociale u shtua. Me çdo inovacion të ri në këtë sferë, u lehtësua funksionimi i njerëzve në shoqëri, në tregti, edukim, shkencë dhe në çdo sferë tjetër. Tani më rrallë mund të flasim për persona që nuk kanë letërnjoftim digjital, profile në aplikacionet e ndryshme të rrjeteve sociale, sepse shumica shfrytëzojnë të mirat e këtij inovacioni që e krijoi vetë njeriu. Por sa prej tyre e përdorin atë nën kontroll, me balancë dhe me vetëdije? Pyetjet e këtilla filluan t'i shqetësojnë studiuesit, të cilët filluan të kërkojnë përgjigje me shkallë (instrumente) të zhvilluara.

Sipas Tutkun-alnal (2015), varësia nga rrjetet sociale është një proces që zhvillohet me proceset njohëse, afektive dhe biheviore që shkakton probleme të tilla si preokupimi, rregullimi i humorit, përsëritja dhe konflikti në shumë fusha të jetës së përditshme si në zonat private (të veçanta), të punës/akademike dhe sociale. Sipas Shoqatës Psikiatrike Amerikane (1994), ankthi social është një gjendje frike e theksuar dhe e vazhdueshme e një ose më shumë situatave shoqërore, ose për shkak të një veprimi të caktuar, kur një individ ballafaqohet me njerëz të panjohur ose sepse mund të jetë nën vëmendjen e të tjerëve. (Aslan, 2020)

Mungesa e hulumtimeve të tilla në vendin tonë ishte motiv për t'i studiuar këto variabla. E shohim të nevojshme të kemi një pasqyrë për këto variabla në vendin tonë, që do të tregojë me statistika nivelin e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social.

Një veçanti e këtij studimi është se realizimit i këtij punimi është bërë gjatë kohës së pandemisë COVID-19. Mendojmë se pandemia ka ndikuar shumë në qëndrimin edhe më të gjatë të njerëzve në rrjete sociale. Dëshira për të marrë informacione të reja dhe për të qenë në vazhdimësi me rrjedhat më të reja të pandemisë në njërin anë dhe qëndrimi sa më shumë në shtëpi në anën tjetër, kanë bërë që njerëzit me ose pa dëshirë të infektohen nga qëndrimi i gjatë në rrjetet sociale. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të gjejë marrëdhënien mes varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social.



I. Korniza teorike e studimit

1.1. Varësia nga rrjetet sociale

Varësia është formimi i një shprehie ndaj një gjëje të caktuar dhe të qenit i varur prej tij gjatë gjithë kohës. Edhe nëse është i angazhuar me një punë tjetër, mund të mendojë vazhdimisht për varësinë ose të mos jetë në gjendje të përqëndrojë vëmendjen e tij tek njerëzit me të cilët ka të bëjë dhe të gjejë veten në shumë gjëra. Po kështu, varësia nga rrjetet sociale i referohet personit që pa vetëdije mbetet prapa nga jeta e përditshme, duke mos qenë në gjendje të bëjë gjërat që duhen bërë, duke qenë larg marrëdhënieve shoqërore dhe duke shikuar vazhdimisht telefonin. Edhe nëse nuk është e dëmshme të kalosh kohë në mediat sociale, duke e bërë atë një shprehje për një kohë të gjatë dhe duke e bërë atë vazhdimisht do të krijojë një shprehje negative për personin. (Sayar, 2019)

Varësia nga mediat sociale ka krijuar një dimension të ri në botën shoqërore. Megjithëse ka përdorime pozitive që sigurojnë komunikim në kohë reale, duke e bërë një përdorues të globalizohet, një platformë më të mirë për marketing etj., nga ana tjetër, varësia ndaj tij rezulton në shqetësimin e gjendjes psikologjike të përdoruesit. Studimet e fundit thonë se rreth 350 milionë përdorues janë të varur nga faqet e mediave sociale. Një në dhjetë adoleshentë refuzohen për punë për shkak të profilit të tyre në mediat sociale. (Chundurur, 2014)

Griffiths (1995); Turel dhe Seronko (2012) theksuan se koncepti i varësisë, i cili quhet dhënie e tepërt ndaj diçkaje, në përgjithësi është vlerësuar për përdorimin e substancave të tilla si alkooli, droga dhe duhani. Ndërkaq, në vitet e fundit, thuhet se disa sjellje të tilla si ngrënia, gjumi, lojërat e fatit dhe stërvitja gjithashtu shkaktojnë varësi. Në situatat e ngjashme vlen edhe për përdorimin e pajisjeve teknologjike të tilla si interneti, kompjuteri, telefoni celular, loja "online" dhe tableti. Në shumë studime, çdo sjellje apo shprehje e pakontrollueshme mund të përkufizohet si varësi. Me përdorimin e teknologjisë në zhvillim, koncepti i varësisë teknologjike ose varësisë nga rrjetet sociale kanë filluar të përdoren tek njerëzit. (Şahin & Yagci, 2017)

Kur dikush i cili është i varur nga rrjetet sociale merr ndjekës të rinj, pëlqime ose komente të reja, ai përjeton lumturi dhe eksitim momental. Kjo ndjenjë është një përvojë që ndodh si rezultat i një shpërblimi të përkohshëm në tru. Nuk është afatgjatë dhe i përhershëm. Ndjenja të tilla si këto, zëvendësojnë lumturinë afatgjatë dhe ndjenjat e thella të atyre që kalojnë shumë kohë në rrjetet sociale, në ndjenja mjaft sipërfaqësore dhe momentale. Kur këto ndjenja përjetojnë shumë shpejt, ato zëvendësohen nga mërzia dhe ankthi.



Si në çdo varësi, edhe në varësinë nga rrjetet sociale, personi për t'u larguar nga mërzia dhe ankthi përsëri përpigjet të përjetojë lumturi afatshkurtër dhe kjo çon të kalojë më shumë kohë në rrjetet sociale. (Sayar, 2019)

Depërtimi i internetit dhe rrjeteve sociale tek ne mund të shkaktojë varësinë nga rrjetet sociale duke virtualizuar nevojat tona si komunikimi në jetën shoqërore, shprehja e vetvetes dhe argëtimi, dhe mund të bëjë që individët të përjetojnë disa probleme shoqërore duke jetuar të izoluar nga jeta shoqërore. (Çömlekçi, M. F. & Başol, O., 2019)

1.2. Ankthi social

Sipas Aktan (2018), ankthi social është një lloj ankthi në të cilin njerëzit shqetësohen për tallje apo poshtërim nga ana e të tjerëve, dhe gjithashtu shihet si shmangia nga mjediset shoqërore. Parashikohet që njerëzit me ankth social nuk do të ndihen komodë në komunikim dhe për këtë arsye do të kenë ankth komunikimi. Ndërkaq, sipas Schlenker & Leary (1982), ankthi social mund të quhet gjithashtu ankthi i njerëzve për të lënë një përshtypje të caktuar tek pala tjetër në mjedise shoqërore reale ose imagjinare. Sipas disa studimeve, është deklaruar se arsyeja kryesore e ankthit social tek njerëzit është ngurrimi i tyre për të shprehur veten në marrëdhëniet shoqërore. (Green, Wilhelmsen, Wilmots, Dodd, Quinn, 2016)

Duke qenë se njerëzit me ankth të lartë shoqëror mund të kalojnë më shumë kohë në rrjetet sociale, kjo mund të ndikojë negativisht në jetën e tyre. (Aktan, 2018) Sipas Andreassen et al. (2016), ndjenja të tilla si ankthi dhe shqetësimi janë të përhapura në mjediset "online", veçanërisht në mesin e përdoruesve të rrjeteve sociale. (Wakefield, 2018)

Kristjánsson et al. (2014) thekson se ankthi i lidhur me përdorimin e mediave sociale mund të shprehet në shumë mënyra, siç janë individët që nuk janë në gjendje të përfundojnë darkën e tyre pa kontrolluar telefonin e tyre për përditësime dhe mesazhe ose nuk mund të dalin nga shtëpia pa e bërë këtë. Gjithashtu, ata mund ta kenë të vështirë të largohen nga shtëpia pa pasur një telefon ose një karikues kompjuteri dhe/ose shqetësohen sepse telefoni i tyre mund të mbetet pa bateri dhe ata nuk mund t'i ndjekin ndërveprimet përmes mediave sociale. Adoleshentët me ankth të lidhur me mediat sociale përditësojnë vazhdimisht lajmet më të reja dhe përditësimet më të fundit në mediat sociale dhe mund të kenë një sfidë të veçantë për ta mposhtur këtë çrregullim, veçanërisht nëse individit ka përdorur mediat sociale për një kohë të gjatë. Sipas Blomfield, Neira dhe Barber (2015), mund të shkaktohen probleme kur njerëzit fillojnë ta jetojnë pjesën më të madhe të jetës së tyre në botën e mediave sociale, sepse më shpesh nuk e pasqyrojnë realitetin me saktësi. Ndërkaq, Banjanin, Banjanin, Dimitrijevic, & Pantic (2015); Farahani et al. (2011); Pantic et al. (2012) treguan se studime të shumta kanë treguar se



të rinjtë që kalojnë më shumë kohë në mediat sociale raportojnë më shumë ankth dhe depresion. (Ólafarson, 2018)

Në shumë studime, është vërejtur se njerëzit me ankth social përdorin më shumë rrjetet sociale. Arsyeja për këtë është se rrjetet sociale nuk kanë ndonjë mjedis hapësinor, përdoruesit e rrjeteve sociale nuk e njohin njëri-tjetrin reciprokisht dhe probabiliteti i takimit është më i ulët. Jepet përfundim se njerëzit me ankth social preferojnë mjedisin e rrjeteve sociale ku nuk i shohin njerëzit, për dallim nga mjediset sociale ku njerëzit janë të pranishëm. Sipas Aktanit, një studim i ndryshëm zbulon se njerëzit që përdorin mediat sociale në mënyrë të tepruar përballen me fenomenin e përdorimit “problematik” të internetit, i cili shkakton ankth social tek njerëzit. (Aktan, 2018).

1.3. Studime të ngjashme

Studime për variablat që po studiojmë tanimë janë bërë në katër anë të botës. Këto studime na tregojnë për nivelin dhe shkaqet e paraqitjes së varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social për popullata të caktuara. Por ndër to kemi një studim që si popullatë e ka gjithë botën, ndërsa si mostër 6.825 individë nga shtatë vende të përzgjedhura për diversitetin e tyre kulturor dhe ekonomik: Brazili, Kina, Indonezia, Rusia, Tajlanda, SHBA-ja dhe Vietnam. Ky studim (Jefferies P. dhe Ungar M., 2020) tregoi rezultate se prevalenca globale e ankthit social ishte dukshëm më e lartë se sa ishte raportuar më parë, me më shumë se 1 në 3 (36%) të anketuar që plotësonin kriteret e pragut për çrregullim të ankthit social. Prevalenca dhe ashpërsia e simptomave të ankthit shoqëror nuk ndryshuan midis gjinive, por ndryshuan në funksion të moshës, vendit, statusit të punës, nivelit të arsimimit dhe nëse një individ jetonte në një vendbanim urban ose rural. Për më tepër, 1 në 6 (18%) e perceptuan veten se nuk kishin ankth shoqëror, megjithatë, e tejkaluan pragun për çrregullim të ankthit social. Të dhënat tregojnë se ankthi social është një shqetësim për të rinjtë në gjithë botën, shumë prej të cilëve nuk i njohin vështirësitë që mund t'i përjetojnë. Një numër i madh i të rinjve mund të përjetojnë ndërprerje thelbësore në funksionimin dhe mirëqenien, të cilat mund të përmirësohen me edukimin dhe ndërhyrjen e duhur, thonë Jefferies P. dhe Ungar M.

Studimi i bërë në Universitetin Hormozgan (Jafari H., Dadipoor S., Haghighi H., Ghanbarnejad A., Zarei E., Moradabadi A. S., 2014) i cili kishte qëllim të ekzaminonte marrëdhënien midis variablave demografike dhe varësisë nga interneti midis 400 studentëve, nxori rezultatet se shumica e subjekteve, saktësisht 182 raste, ishin përdorues tipikë të internetit, 175 përdorues ishin në rrezik dhe 43 përdorues u identifikuan si përdorues të varur nga interneti. Rezultatet gjithashtu tregojnë se pesë faktorët demografikë (gjinia, statusi martesor, moshë, niveli arsimor dhe disiplina) janë të lidhur me varësinë nga interneti.



Në kohën e pandemisë u analizuan postimet në rrjetet sociale dhe ankthi që shkaktohet prej tyre; sepse u vërejt që në kohën e pandemisë COVID-19, shkarkimet dhe postimet në këto rrjete arritën majën. Kur shikojmë aplikacionet e rrjeteve sociale, aksionet e përdoruesve në platforma tejkaluan 275 milionë postime. U pa se përdoruesit që ndanë më shumë ishin në Japoni, SHBA dhe Korenë e Jugut. Kur shikojmë periudhën midis datave 21 janar - 11 mars të vitit 2020, 275 milionë postime u ndanë në lidhje me pandeminë në gjithë botën dhe ky numër ishte rreth 6,5 milionë në Turqi (Leventler, Bakırçalı dhe Gönül, 2020). Në të njëjtën kohë, në këtë periudhë, u prodhuan shumë fushata dezinformimi në lidhje me virusin (skenarin e planifikuar të pandemisë), pretendimet për sulme biologjike. Dezinformimi filloi të përhapet me shpejtësi, pasi thashethemet se virusi vdekjeprurës në Wuhan u prodhua në laborator u shtuan. (Inceoğlu, 2020) Kjo shkaktoi rritje të ankthit në popullatë, por studimet tregojnë edhe për ndikimin e postimeve të besueshme dhe pozitive. Kur besimi në postimet zyrtare të rrjeteve sociale në COVID-19 rritet, niveli i ankthit zvogëlohet dhe perceptimi i kontrollit të sëmundjes COVID-19 rritet; gjithashtu u vërejt se derisa ekspozimi ndaj përmbajtjes negative të rrjeteve sociale për COVID-19 u rrit, niveli i ankthit u rrit dhe perceptimi i kontrollit të sëmundjes COVID-19 u ul. (Şentürk E., Geniş B., Menkü B. ve Cosar B, 2020)

Në studimin e bërë nga Çomlekçi dhe Başol (2019), të dhënat tregojnë që të rinjtë mesatarisht përdorin katër orë e 16 minuta rrjetet sociale. Në të njëjtin hulumtim është zbuluar se ekziston korrelacion mes qëllimit të përdorimit të rrjeteve sociale dhe varësisë nga rrjetet sociale.

Kur kërkojmë nëse kemi korrelacion të rëndësishëm mes sasisë së aplikacioneve dhe varësisë nga rrjetet sociale, studimi i Ünal (2016) na vërteton se me rritjen e sasisë së aplikacioneve rritet edhe varësia nga rrjetet sociale. Ai në studimin e tij gjithashtu ka gjetur një detaj të rëndësishëm që ka të bëjë me përdorimin e rrjeteve sociale tek femrat dhe meshkujt; ato kishin një përdorim të përafërt. Por ajo që i dallon është se tek femrat angazhimi dhe statusi emocional shkakton më shumë varësi, ndërsa tek meshkujt krijon konflikt.



II. Metodologjia

2.1. Qëllimi i studimit

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të gjejë marrëdhënien në mes të varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social. Përveç qëllimit kryesor, kemi parashtruar edhe qëllime të tjera, si identifikimi i nivelit të varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te pjesëmarrësit, identifikimi i dallimeve në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social sipas gjinisë, grupmoshës, statusit martesor, vendit të jetesës, nivelit të arsimimit, statusit të punës, numrit të orëve që qëndrojnë në rrjete sociale dhe mjetit elektronik që e përdorin më së shumti.

2.2. Pyetjet kërkimore

Procesi i hulumtimit është proces i ndjeshëm dhe i komplikuar, fazat e të cilit kërkojnë kujdes dhe përkushtim të veçantë. Në një proces hulumtues pas identifikimit të nevojës dhe qëllimit për hulumtim, nevojitet të parashtrohen pyetjet kërkimore që janë relevante për t'i arritur qëllimet e parapara. Pyetja kryesore e këtij hulumtimi është të gjejë se cila është marrëdhënia mes varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social.

Përveç kësaj, ky studim do t'u japë përgjigje edhe pyetjeve kërkimore në vazhdim:

- A ekzistojnë dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te meshkujt dhe femrat?
- A ekzistojnë dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te grupmoshat e ndryshme të pjesëmarrësve?
- A ekzistojnë dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te pjesëmarrësit sipas statusit martesor?
- A ekzistojnë dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te pjesëmarrësit e vendeve të ndryshme që kanë qenë pjesë e studimit?
- A ekzistojnë dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te pjesëmarrësit me shkollë të mesme, fakultet, magjistraturë dhe doktoratë?
- A ekzistojnë dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te punonjësit që punojnë me orar të plotë, punonjësit me orar të pjesshëm, të papunësuarit dhe studentët?



- A ekzistojnë dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social sipas numrit të orëve që pjesëmarrësit kalojnë brenda ditës në rrjete sociale?
- A ekzistojnë dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social sipas mjetit elektronik që pjesëmarrësit e përdorin më së shumti: smartfon, laptop ose kompjuter?

2.3. Hipotezat e studimit

1. Ekziston korrelacion pozitiv mes varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social.

2. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te meshkujt dhe femrat.

2.1. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale te meshkujt dhe femrat.

2.2. Ekzistojnë dallime në nivelin e ankthit social te meshkujt dhe femrat.

3. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social sipas grupmoshës së pjesëmarrësve.

3.1. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale sipas grupmoshës së pjesëmarrësve.

3.2. Ekzistojnë dallime në nivelin e ankthit social sipas grupmoshës së pjesëmarrësve.

4. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te pjesëmarrësit e fejuar, të martuar dhe ata beqarë.

4.1. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale te pjesëmarrësit e fejuar, të martuar dhe ata beqarë.

4.2. Ekzistojnë dallime në nivelin e ankthit social te pjesëmarrësit e fejuar, të martuar dhe ata beqarë.

5. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te pjesëmarrësit e vendeve të ndryshme që kanë qenë pjesë e studimit.

5.1. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale te pjesëmarrësit e vendeve të ndryshme që kanë qenë pjesë e studimit.

5.2. Ekzistojnë dallime në nivelin e ankthit social te pjesëmarrësit e vendeve të ndryshme që kanë qenë pjesë e studimit.

6. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te pjesëmarrësit me shkollë të mesme, fakultet, magjistraturë dhe doktoratë.



6.1. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale te pjesëmarrësit me shkollë të mesme, fakultet, magjistraturë dhe doktoratë.

6.2. Ekzistojnë dallime në nivelin e ankthit social te pjesëmarrësit me shkollë të mesme, fakultet, magjistraturë dhe doktoratë.

7. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te punonjësit që punojnë me orar të plotë, punonjësit me orar të pjesshëm, të papunësuarit dhe studentët.

7.1. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale te punonjësit që punojnë me orar të plotë, punonjësit me orar të pjesshëm, të papunësuarit dhe studentët.

7.2. Ekzistojnë dallime në nivelin e ankthit social te punonjësit që punojnë me orar të plotë, punonjësit me orar të pjesshëm, të papunësuarit dhe studentët.

8. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social sipas numrit të orëve që pjesëmarrësit kalojnë brenda ditës në rrjete sociale.

8.1. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale sipas numrit të orëve që pjesëmarrësit kalojnë Brenda ditës në rrjete sociale.

8.2. Ekzistojnë dallime në nivelin e ankthit social sipas numrit të orëve që pjesëmarrësit kalojnë brenda ditës në rrjete sociale.

9. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social sipas mjetit elektronik që pjesëmarrësit e përdorin më së shumti: smartfon, laptop ose kompjuter.

9.1. Ekzistojnë dallime në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale sipas mjetit elektronik që pjesëmarrësit e përdorin më së shumti: smartfon, laptop ose kompjuter.

9.2. Ekzistojnë dallime në nivelin e ankthit social sipas mjetit elektronik që pjesëmarrësit e përdorin më së shumti: smartfon, laptop ose kompjuter.

2.4. Operacionalizimi i variablave

2.4.1. Varësi nga rrjetet sociale: Shuma e përgjigjeve të pjesëmarrësve nga "1-Aspak nuk është e përshtatshme për mua" deri në "5-Është shumë e përshtatshme për mua" do të paraqesë nivelin e varësisë nga rrjetet sociale.

Variabla përbëhet nga dy indikatorë:

1. Toleranca virtuale dhe
2. Komunikimi virtual



2.4.2. Ankthi social: Shuma e përgjigjeve të pjesëmarrësve nga "1-Asnjëherë" deri në "5- Çdoherë" do të paraqesë shkallën e ankthit social.

Variabla përbëhet nga katër indikatorë:

1. Ankthi i përmbajtjes
2. Shqetësimi për privatësinë
3. Ankthi i ndërveprimit
4. Ankthi i vetëvlerësimit

2.5. Popullacioni dhe mostra

Popullacion i këtij studimi janë qytetarët e nëntë vendeve të Ballkanit (Maqedonia e Veriut, Kosova, Shqipëria, Greqia, Bullgaria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Kroacia) të cilët janë përdorues të internetit dhe kanë të hapur llogari në rrjetet sociale. Mostër e studimit janë pjesëmarrësit të cilët kanë pasur qasje deri te linku i pyetësorit. Kemi zgjedhur vendet e Ballkanit për arsye se si vende fqinje kemi kulturë, status ekonomik dhe kushte të përafërta jetese. Pyetësorin e kanë plotësuar gjithësej 330 pjesëmarrës nga nëntë shtetet e sipërmendura të Ballkanit. Ky numër i mostrës padyshim që është shumë i vogël në krahasim me numrin e popullsisë së përgjithshme dhe në studimet e ardhshme do ta kemi parasysh si faktor limitues. Fokusi ynë githnjë ka qenë që në studim të jenë të përfshirë studentët që kanë marrë pjesë në projektet e Shkollave Rinore Balkanike të mbështetura nga YTB-ja. Pjesa më e madhe e atyre që kanë marrë pjesë janë nga Republika e Maqedonisë së Veriut (N=171), 51 nga Shqipëria, 39 nga Kosova, 33 nga Greqia, 19 nga Bosnja dhe Hercegovina, 13 nga Serbia, dy nga Mali i Zi dhe nga një pjesëmarrës nga Bullgaria dhe Kroacia. Targeti ynë kryesor kanë qenë të rinjtë nga moshë 16 deri në 25 vjeç, por të drejtë pjesëmarrjeje kanë pasur edhe ata mbi këtë moshë.

2.6. Instrumentet matëse

Në këtë studim kemi përdorur dy instrumente matëse të inkorporuara në një të vetëm për subjektin. Pyetësori ka qenë i ndarë në tri pjesë: pjesa e parë është pjesa demografike, pjesa e dytë është pyetësori për varësinë nga rrjetet sociale dhe pjesa e tretë pyetësori për ankthin social. Në fillim i kemi vendosur udhëzimet në lidhje me plotësimin e pyetësorit, pastaj vijmë nëntë pyetjet demografike të cilat përmbajnë informacione të përgjithëshme për pjesëmarrësin si: gjinia, moshë, vendi ku jetojnë, niveli arsimor i kryer, statusi i punës, statusi martesor, rrjeti social të cilin e përdorin më shumë, numri i orëve që qëndrojnë në rrjete sociale dhe cilin mjet elektronik e përdorin më shumë. Pas variablave demografike pason pyetësori i parë për varësinë nga rrjetet sociale i cili përmban 28 pohime. Pyetësorin e kemi marrë nga



autorët Cengiz Şahin dhe Mustafa Yağci (2017). Besueshmëria e brendshme e instrumentit në studimin e realizuar nga autorët është (Alpha= 0,94), e cila tregon për konzistencë të brendshme të lartë të pyetësorit. Pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të zgjedhin një të një nga pesë alternativat e mundëshme të shkallës së Likertit të cilat kanë domethënien përkatëse nga: (1) Aspak nuk është i përshtatshëm për mua; (2) Nuk është e përshtatshme për mua; (3) Nuk mund të vendos; (4) E përshtatshme për mua; dhe (5) Është shumë e përshtatshme për mua. Duhet të cekim se në pyetësorin që e kemi përdorur ne, kemi bërë ndryshime në disa nga pohimet të cilat i kemi parë si të arsyeshme t'i ambientojmë për vendin dhe mentalitetin tonë. Pjesa e tretë është pyetësori për ankthin social i cili është zhvilluar nga Alkış, Kadirhan dhe Sat (2017), të cilin e kemi marrë nga punimi i Tülay Aslan, 2020. Ky pyetësor përmban 20 pohime dhe gjithashtu e kemi përshtatur. Pjesëmarrësit kanë mundësi të zgjedhin një të një nga pesë alternativat e mundëshme me domethënien përkatëse: (1) Asnjëherë; (2) Rrallëherë; (3) Kohë pas kohe; (4) Zakonisht; dhe (5) Çdoherë. Besueshmëria e brendshme e pyetësorit në studimin e autores më lartë u gjet se është (Alpha= 0,89), që tregon besueshmëri të lartë të instrumentit.

2.6.1. Besueshmëria e instrumenteve matëse

Statistikat për besueshmërinë e brendshme të instrumenteve matëse sipas Alpha Cronbachut janë shumë të larta për të dy instrumentet. Vlera e Alpha Cronbachut për varësinë nga rrjetet sociale është (Alpha= 0,872) dhe për ankthin social (Alpha= 0,895). Kjo vërteton për konzistencë të brendshme të lartë mes pyetjeve të dy pyetësorëve.

Tabela 1. Statistika e besueshmërisë së brendshme të instrumentit për varësinë nga rrjetet sociale.

Cronbach's Alpha	N of Items
.872	28

Tabela 2. Statistika e besueshmërisë së brendshme të instrumentit për ankthin social.

Cronbach's Alpha	N of Items
.895	20

2.7. Metodatat statistikore për përpunimin e të dhënave

Nëpërmjet pyetësorëve janë siguruar të dhëna të strukturuar nga pjesëmarrësit të cilat janë analizuar me anë të veglave statistikore përkatëse për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore. Analiza e të dhënave është bërë me programin statistikor SPSS.16. dhe kemi përdorur këto statistika: statistika deskriptive (përskruese) për të dhënat demografike si gjinia,



mosha, niveli i arsimimit, statusi martesor, statusi i punës, vendi i banimit, kohëzgjatja e qëndrimit në rrjete sociale, mjete elektronik që e përdorin më shumë si dhe përdorues të cilit rrjet social janë më së shumti. Për besueshmërinë e brendshme të instrumenteve matëse kemi përdorur Alpha Cronbachun, ndërsa për shpërndarjen normale statistikën e Kolmogorov-Smirnovit. Për marrëdhënien mes varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social kemi përdorur korrelacionin e Pearsonit. Për dallimet mes gjinisë në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social kemi përdorur T-testin, kurse për dallimet sipas moshës, statusit martesor, vendit të jetesës, nivelit të arsimimit, statusit të punës, kohëzgjatjes së qëndrimit në rrjete sociale dhe mjetit elektronik që e përdorin më së shumti, kemi përdorur Anovën.

2.8. Realizimi i hulumtimit

Ky projekt hulumtues u realizua duke përdorur metodologjinë e kërkimeve kuantitative apo sasiore. Pyetësi është përgatitur dhe shpërndarë në formë elektronike. Shpërndarja e tij është bërë nëpërmjet rrjeteve sociale, kryesisht nëpërmjet aplikacionit Whatsapp. Pjesëmarrja në studim ka qenë në mënyrë vullnetare. Gjithashtu, pjesëmarrësit kanë pasur të drejtë të tërhiqen nga studimi kur të duan. Plotësimi i pyetësorit nuk ka zgjatur më shumë se dhjetë minuta. Mbledhja e të dhënave ka zgjatur nga data 23 maj deri më 14 qershor 2021. Pjesëmarrësve u kemi siguruar anonimitet të plotë.

Përpunimi i të dhënave është bërë me paketën për përpunime statistikore SPSS.16. Ky hulumtim realizohet në kuadër të Shkollave Rinore Ballkanike, më konkretisht projektit **“Shoqëria digjitale dhe njeriu”** të realizuar nga shoqata Fettah Efendi dhe mbështetur nga Presidenca e Turqve Jashtë Vendi dhe Komuniteteve Mike (YTB). Shpallja e rezultateve do të bëhet në një panel diskutimi të realizuar në Shkup.




III. Rezultate

3.1. Rezultatet për karakteristikat demografike

Në tabelën 3 shohim se në studim kanë marrë pjesë 79 meshkuj (23,9%) dhe 251 femra (76,1%).

Tabela 3. Gjinia e pjesëmarrësve.

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Male	79	23,9	23,9	23,9
Female	251	76,1	76,1	100,0
Total	330	100,0	100,0	




Grafiku 1. Pjesëmarrja sipas gjinisë me anë të paraqitjes grafike.



Në tabelën numër 4 shohim se numri më i madh i pjesëmarrësve në hulumtim (48%) janë mes moshës 16-18 vjeç, 35% i takojnë grupmoshës 18-24 vjeç, 12% janë të grupmoshës 24-30 vjeç dhe 5% janë mbi 30 vjeç.

Tabela 4. Moshë e pjesëmarrësve.

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 16-18	160	48,5	48,5	48,5
18-24	115	34,8	34,8	83,3
24-30	39	11,8	11,8	95,2
30 and over	16	4,8	4,8	100,0
Total	330	100,0	100,0	




Grafiku 2. Moshë e pjesëmarrësve me anë të paraqitjes grafike.



Nga tabela numër 5 shohim se nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve (N=330), se numri më i madh i pjesëmarrësve, 82%, janë beqarë, rreth 10% të martuar dhe 8% të fejuar.

Tabela 5. Të dhënat për statusin martesor të pjesëmarrësve.

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid engaged	28	8,5	8,5	8,5
married	32	9,7	9,7	18,2
single	270	81,8	81,8	100,0
Total	330	100,0	100,0	




Grafiku 3. Statusi martesor i pjesëmarrësve me anë të paraqitjes grafike.



Në tabelën numër 6 janë paraqitur statistikat deskriptive për sa i përket vendit të pjesëmarrësve, ku shihet qartë se gjysma e numrit të pjesëmarrësve janë nga Republika e Maqedonisë së Veriut (52%), më pas vijojnë pjesëmarrësit nga Shqipëria me rreth 16%, rreth 12% janë nga Kosova, 10% nga Greqia dhe pjesa tjetër janë pjesëmarrësit nga Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Bullgaria dhe Serbia.

Tabela 6. Të dhënat për shtetin në të cilin jetojnë pjesëmarrësit.

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid North Macedonia	171	51,8	51,8	51,8
Kosovo	39	11,8	11,8	63,6
Albania	51	15,5	15,5	79,1
Montenegro	2	,6	,6	79,7
Bosnia and Herzegovina	19	5,8	5,8	85,5
Croatia	1	,3	,3	85,8
Greece	33	10,0	10,0	95,8
Bulgaria	1	,3	,3	96,1
Serbia	13	3,9	3,9	100,0
Total	330	100,0	100,0	



Grafiku 4. Vendi i banimit të pjesëmarrësve me anë të paraqitjes grafike.




Nga tabela 7 shohim se 54% e pjesëmarrësve kanë të kryer studimet diplomike dhe postdiplomike, më pas renditen pjesëmarrësit me shkollë të mesme me 42,4%, kurse pjesëmarrja më e ulët është e atyre me shkollë fillore me 3,6%.

Tabela 7. Niveli arsimor i pjesëmarrësve.

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Elementary	12	3,6	3,6	3,6
Middle teaching	140	42,4	42,4	46,1
License	138	41,8	41,8	87,9
Masters's degree	35	10,6	10,6	98,5
Doctorate	5	1,5	1,5	100,0
Total	330	100,0	100,0	

Your level of education:




Grafiku 5. Niveli i arsimimit të pjesëmarrësve me anë të paraqitjes grafike.



Në tabelën numër 8 shohim se 15% e pjesëmarrësve janë deklaruar si të punësuar me orar të plotë, 5% janë të punësuar me orar të pjesshëm, 12% janë të papunësuar dhe 68% janë studentë.

Tabela 8. Statusi i punës.

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Full-time employee	51	15,5	15,5	15,5
Part-time employer	16	4,8	4,8	20,3
Unemployed	40	12,1	12,1	32,4
Student	223	67,6	67,6	100,0
Total	330	100,0	100,0	




Grafiku 6. Statusi i punës së pjesëmarrësve me anë të paraqitjes grafike.



Nga tabela numër 9 shihet se gati gjysma e pjesëmarrësve (48,5%) përdorin rrjetet sociale 3-4 orë, 18,5 % i përdorin 5-6 orë, 23% 1 deri 2 orë në ditë, 7% i përdorin rrjetet sociale 7-8 orë dhe 3% deklarojnë mbi 8 orë.

Tabela 9. Numri i orëve në rrjetet sociale brenda një dite.

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1-2 hours	75	22,7	22,7	22,7
3-4 hours	160	48,5	48,5	71,2
5-6 hours	61	18,5	18,5	89,7
7-8 hours	24	7,3	7,3	97,0
more than 8 hours	10	3,0	3,0	100,0
Total	330	100,0	100,0	



Grafiku 7. Qëndrimi në rrjete sociale brenda ditës me anë të paraqitjes grafike.




Nga tabela numër 10 vërehet se 94% e pjesëmarrësve përdorin më së shumti celularin apo smartfonin, 4% laptopin dhe vetëm 2% e përdorin kompjuterin. Ndërkaq, rrjetet sociale që përdoren më së shumti nga pjesëmarrësit janë Instagrami, Whatsapp-i dhe Snapchat-i.

Tabela 10. Mjeti elektronik që e përdorin më së shumti.

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Laptop computer	13	3,9	3,9	3,9
Computer	8	2,4	2,4	6,4
Phone	309	93,6	93,6	100,0
Total	330	100,0	100,0	

Which electronic tool do you most use?



Grafiku 8. Mjeti elektronik që pjesëmarrësit e përdorin më së shumti.

3.2. Paraqitja deskriptive e variablave

Mesatarja e arritur e varësisë nga rrjetet sociale është ($M=69,26$, $SD=1,57$) me minimum ($Min=34$) dhe maksimum ($Max=120$). Vlera e mesatares së arritur është nën vlerën e mesatares së pritur ($M=77$), që nënkupton se pjesëmarrësit kanë treguar nivel të ulët të varësisë nga rrjetet sociale.



Vlera e mesatares së arritur për ankthin social është (M=46,90, SD=1,42) që është më e ulët se mesatarja e pritur (M=60). Minimumi për akthin social është (Min=20) dhe maksimumi (Max=100). Vlera e ankthit social te pjesëmarrësit është më e ulët se mesatarja.

Tabela 11. Të dhënat përshkruese për varësinë dhe ankthin te pjesëmarrësit.

		Varësia	Ankthi
N	Valid	330	330
	Missing	0	0
Mean		69,2697	46,9030
Std. Deviation		1,57361E1	1,42774E1
Minimum		34,00	20,00
Maximum		120,00	100,00


Në tabelën numër 12 dhe paraqitjen grafike numër 9 është paraqitur statistika për shpërndarjen normale sipas Kolmogorov-Smirnovit e cila na tregon se vlerat e pjesëmarrësve për varësinë nga rrjetet sociale janë në kufi të normales (sig>0.05), respektivisht ekziston shpërndarje normale.

Tabela 12. Statistika e shpërndarjes normale për varësinë nga rrjetet sociale.

	Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk		
	Statistic	Df	Sig.	Statistic	df	Sig.
Varësia	,037	330	,200	,992	330	,056

a. Lilliefors Significance Correction

*. This is a lower bound of the true significance.



Grafiku 9. Shpërndarja e variablës varësia nga rrjetet sociale.




Sipas tabelës me numër 13 dhe paraqitjes grafike me numër 10, statistika e Kolmogorov Smirnov-it për ankthin social (sig< 0.05) tregon se nuk kemi shpërndarje normale të variablës ankthi social.

Tabela 13. Statistika e shpërndarjes normale për ankthin social.

	Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk		
	Statistic	Df	Sig.	Statistic	df	Sig.
Ankthi	,056	330	,016	,982	330	,000

a. Lilliefors Significance Correction



Grafiku 10. Shpërndarja e variablës ankthi social.

3.3. Analiza e hipotezave

Nga tabela në vazhdim shohim se ekziston korrelacion pozitiv mesatar mes varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social ($r=0,447$), i cili është i rëndësishëm statistikisht ($p<0.01$). Kjo ka domethënie se me rritjen e varësisë nga rrjetet sociale rritet edhe ankthi social. Hipoteza e parë verifikohet.

Tabela 14. Korrelacioni mes variablave kryesore

		Varësia	Ankthi
Varësia	Pearson Correlation	1	,447**
	Sig. (2-tailed)		,000
	N	330	330
Ankthi	Pearson Correlation	,447**	1
	Sig. (2-tailed)	,000	
	N	330	330

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).



Nga tabela shohim se mesatarja e meshkujve në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale është ($M=71.97, SD=16.53$), ndërsa e femrave ($M=68.41, SD=15.41$). Analiza e dallimit të mesatareve ($t=1,757, df=328, p=0,080$) konstaton se nuk ekzistojnë diferenca mesataresh statistikisht të rëndësishme mes meshkujve dhe femrave në nivelin e varësisë nga rrjetet sociale. Me këtë, hipoteza 2.1. refuzohet.

Nga tabela më poshtë gjithashtu vërejmë se mesatarja e meshkujve në shkallën e ankthit social është ($M=47,64, SD=15.19$), ndërsa e femrave ($M=46.66, SD=14.00$). Analiza e dallimit ($t=0,529, df=328, p=0,597$) konstaton se gjithashtu nuk ekzistojnë diferenca mesataresh statistikisht të rëndësishme mes meshkujve dhe femrave në nivelin e ankthit social. Hipoteza numër 2.2. refuzohet.

Tabela 15. Të dhënat përshkruese për pjesëmarrësit sipas gjinisë në shkallën varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social.

Your gender	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean
Varësia Male	79	71,9747	16,53355	1,86017
Female	251	68,4183	15,41260	,97283
Ankthi Male	79	47,6456	15,19281	1,70932
Female	251	46,6693	14,00051	,88370

Tabela 16. Testi t për krahasimin e mesatareve sipas gjinisë.

	Levene's Test for Equality of Variances	t-test for Equality of Means								
		F	Sig.	t	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	Std. Error Difference	95% Confidence Interval of the Difference	
									Lower	Upper
Varësia	Equal variances assumed	,305	,581	1,757	328	,080	3,55636	2,02363	-,42457	7,53728
	Equal variances not assumed			1,694	123,617	,093	3,55636	2,09920	-,59867	7,71139
Ankthi	Equal variances assumed	,728	,394	,529	328	,597	,97625	1,84388	-2,65107	4,60356
	Equal variances not assumed			,507	122,537	,613	,97625	1,92425	-2,83282	4,78532

Mesatare më të lartë në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale kanë arritur pjesëmarrësit e grupmoshës 30 vjeç e më lart me mesatare ($M=72,25, SD=16,63$); pastaj pjesëmarrësit e grupmoshës 16-18 vjeç me mesatare ($M=69,55, SD=15,65$); pas tyre renditen pjesëmarrësit e grupmoshës 24-29 ($M=68,82, SD=19,16$); dhe të fundit janë grupmosha 18-24 vjeç të cilët kanë arritur mesatare ($M=68,60, SD=14,55$). Testi i Levinit nuk është statistikisht i rëndësishëm, që do të thotë se kemi të drejtë krahasimi mes grupeve. Vlera e Anovës $F(329)=0,285$ dhe $p=0,836$ tregon se dallimet e mesatareve të grupeve nuk janë statistikisht të rëndësishme. Kjo nënkupton se nuk ka

dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale sipas grupmoshave të ndryshme të pjesëmarrësve. Me këtë, hipoteza e parashtruar me numër 3.1. refuzohet.

Në shkallën e ankthit social, mesatare më të lartë kanë arritur grupmosha 24-30 vjeç me mesatare (M=47,56, SD=13,34); të dytët renditen 16-18 vjeç me mesatare (M=47,25, SD=15,27); të tretët grupmosha 30 e më lart me vlerë të mesatares (M=46,50, SD=10,19); dhe të fundët grupmosha 18-24 vjeç me mesatare (M=46,25, SD=13,74). Sipas vlerës së F(329) dhe p=0,935 konstatojmë se nuk kemi dallime të rëndësishme statistikore, respektivisht nuk kemi dallime mes grupmoshave të ndryshme në shkallën e ankthit social. Me këtë, hipoteza 3.2. refuzohet.

Tabela 17. Të dhënat përshkruese sipas grupmoshave të ndryshme në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social.

	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error	F	Sig.
Varësia	16-18	160	69,5562	15,65860	1,23792	,285 ,836
	18-24	115	68,6087	14,55823	1,35756	
	24-29	39	68,8205	19,16394	3,06869	
	30 and over	16	72,2500	16,63931	4,15983	
	Total	330	69,2697	15,73614	,86625	
Ankthi	16-18	160	47,2500	15,27649	1,20771	,142 ,935
	18-24	115	46,2522	13,74635	1,28185	
	24-30	39	47,5641	13,34915	2,13757	
	30 and over	16	46,5000	10,19150	2,54787	
	Total	330	46,9030	14,27742	,78595	

Të martuarit kanë arritur mesatare më të lartë në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale (M=71, 81, SD=15,23), të dytët renditen beqarët me mesatare (M=69,68, SD=15,38) dhe të tretët të fejuarit me mesatare (M=62,32, SD=18,25). Vlera e F(329)=3,288 dhe p=0,039 vërteton se ka dallime të rëndësishme statistikore mes të fejuarve, të martuarve dhe beqarëve në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale. Hipoteza 4.1. vërtetohet.

Në shkallën e ankthit social mesatare më të lartë kanë treguar beqarët me mesatare (M=47,31, SD=14,47); pastaj të fejuarit (M=45, 39, SD=14,93); dhe në fund të martuarit me vlerë të mesatares (M=44,71, SD=11,93). Vlera e F(329)=0,644 dhe p=0,526 na tregon se nuk kemi dallime të rëndësishme statistikore mes pjesëmarrësve beqarë, të fejuar dhe të martuar në nivelin e ankthit social. Hipoteza 4.2. refuzohet.



Tabela 18. Të dhënat përshkruese sipas statusit martesor në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social.

	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error	F	Sig.
Varësia engaged	28	62,3214	18,25144	3,44920	3,288	,039
married	32	71,8125	15,23459	2,69312		
single	270	69,6889	15,38525	,93632		
Total	330	69,2697	15,73614	,86625		
Ankthi engaged	28	45,3929	14,93031	2,82156	,644	,526
married	32	44,7188	11,93054	2,10904		
single	270	47,3185	14,47605	,88098		
Total	330	46,9030	14,27742	,78595		

Në rend të parë, mesatare më të lartë në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale ka arritur pjesëmarrësi nga Bullgaria me mesatare ($M=76$); në rend të dytë pjesëmarrësit nga Serbia me mesatare ($M=74,30$, $SD=15,13$); në rend të tretë vijnë pjesëmarrësit nga Kosova ($M=72,56$, $SD=17,72$); në rend të katërt pjesëmarrësit nga Greqia me mesatare ($M=69,81$, $SD=14,36$); në rend të pestë pjesëmarrësit nga Maqedonia e Veriut me mesatare ($M=69,39$, $SD=15,73$); në rend të gjashtë respondentët nga Shqipëria me mesatare ($M=66,29$, $SD=14,93$); në rend të shtatë pjesëmarrësit nga Bosnja dhe Hercegovina ($M=66,15$, $SD=16,54$); në rend të tetë renditen ata nga Mali i Zi ($M=60,50$, $SD=16,26$); dhe i fundit pjesëmarrësi nga Kroacia me mesatare ($M=57$). Edhe pse shohim se kemi dallim mes mesatareve, analiza e dallimit Anova, me vlerë të $F(329)=0,881$ dhe $p=0,532$ vërteton se këto dallime nuk janë statistikisht të rëndësishme. Kjo nënkupton se nuk kemi dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale të pjesëmarrësit sipas vendeve të ndryshme të jetesës. Sipas këtij rezultati, hipoteza 5.1. refuzohet.

Në shkallën e ankthit social, mesatare më të lartë ka arritur pjesëmarrësi nga Bullgaria me mesatare ($M=60,00$); pastaj nga Kroacia ($M=53,00$); në rend të tretë pjesëmarrësit nga Greqia ($M=52,72$, $SD=11,48$); në rend të katërt pjesëmarrësit nga Kosova me mesatare ($M=48,25$, $SD=16,79$); në rend të pestë pjesëmarrësit nga Shqipëria me mesatare ($M=46,29$, $SD=13,58$); në rend të gjashtë pjesëmarrësit nga Maqedonia e Veriut me mesatare ($M=46,02$, $SD=15,73$); në rend të shtatë pjesëmarrësit nga Serbia me mesatare të arritur ($M=45,00$, $SD=15,18$); në rend të tetë pjesëmarrësit nga Bosnja dhe Hercegovina ($M=44,31$, $SD=13,84$); dhe të fundit renditen pjesëmarrësit nga Mali i Zi me mesatare ($M=42,00$, $SD=0,00$). Vlera e $F(329)$ është $1,089$ dhe $p=0,371$, që tregon se dallimet mes grupeve nuk janë të rëndësishme, respektivisht nuk ka dallime në shkallën e ankthit social të pjesëmarrësit sipas vendeve të ndryshme të jetesës. Hipoteza 5.2. refuzohet.



Tabela 19. Të dhënat përshkruese sipas vendit të jetesës në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social.

	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error	F	Sig.
Varësia North Macedonia	171	69,3977	15,73213	1,20307	,881	,532
Kosovo	39	72,5641	17,72716	2,83862		
Albania	51	66,2941	14,93893	2,09187		
Montenegro	2	60,5000	16,26346	11,50000		
Bosnia and Herzegovina	19	66,1579	16,54712	3,79617		
Croatia	1	57,0000	.	.		
Greece	33	69,8182	14,36240	2,50017		
Bulgaria	1	76,0000	.	.		
Serbia	13	74,3077	15,13486	4,19766		
Total	330	69,2697	15,73614	,86625		
Ankthi North Macedonia	171	46,0292	14,32785	1,09568		
Kosovo	39	48,2564	16,79398	2,68919		
Albania	51	46,2941	13,58866	1,90279		
Montenegro	2	42,0000	,00000	,00000		
Bosnia and Herzegovina	19	44,3158	13,84860	3,17709		
Croatia	1	53,0000	.	.		
Greece	33	52,7273	11,48987	2,00013		
Bulgaria	1	60,0000	.	.		
Serbia	13	45,0000	15,18771	4,21231		
Total	330	46,9030	14,27742	,78595		

Sipas nivelit të arsimimit, nivel më të lartë në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale kanë arritur pjesëmarrësit me shkollë fillore ($M=82,33, SD=17,86$); pastaj në rend të dytë vijnë ata me doktoratë me mesatare ($M=80,80, SD=5,01$); më pas në rend të tretë vijnë pjesëmarrësit me shkollë të mesme me mesatare ($M=70,15, SD=15,70$); në rend të katërt pjesëmarrësit me fakultet me mesatare ($M=68,51, SD=14,44$); dhe në fund ata me magjistraturë me mesatare ($M=62,57, SD=17,56$). Vlera e $F(329)$ është 4,719 kurse $p=0,001$. Kjo vlerë na tregon se ka dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale sipas nivelit të arsimimit të pjesëmarrësve. Hipoteza numër 6.1.verifikohet.

Mesatare më të lartë në shkallën e ankthit social kanë arritur pjesëmarrësit me arsim fillor me mesatare ($M=54,91, SD=16,61$); pastaj të dytë janë pjesëmarrësit me doktoratë me mesatare ($M=51,40, SD=6,50$); në rend të tretë pjesëmarrësit me shkollë të mesme ($M=49,04, SD=14,68$); në rend të katërt pjesëmarrësit me fakultet ($M=44,60, SD=13,28$); dhe të fundit renditen pjesëmarrësit me magjistraturë ($M=44,02, SD=14,51$). Sipas vlerës së $F(329)=3,180$ dhe $p=0,014$ konstatohet se ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në shkallën e ankthit social sipas nivelit të arsimimit të pjesëmarrësve. Hipoteza me numër 6.2. verifikohet.



Tabela 20. Të dhënat përshkruese sipas nivelit të arsimit në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social.

	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error	F	Sig.
Varësia						
Elementary	12	82,3333	17,86481	5,15713		
Middle teaching License	140	70,1571	15,70835	1,32760		
Masters's degree	138	68,5145	14,44761	1,22986	4,719	,001
Doctorate	35	62,5714	17,56548	2,96911		
Total	5	80,8000	5,01996	2,24499		
	330	69,2697	15,73614	,86625		
Ankthi						
Elementary	12	54,9167	16,61028	4,79498		
Middle teaching License	140	49,0429	14,68561	1,24116		
Masters's degree	138	44,6014	13,28714	1,13108	3,189	,014
Doctorate	35	44,0286	14,51467	2,45343		
Total	5	51,4000	6,50385	2,90861		
	330	46,9030	14,27742	,78595		

Mesatare më të lartë në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale kanë arritur pjesëmarrësit që punojnë me orar të pjesshëm (part-time) me mesatare ($M=73,75$, $SD=10,80$); pastaj në rend të dytë pjesëmarrësit që punojnë me orar të plotë ($M=69,50$, $SD=18,20$); pastaj studentët ($M=69,22$, $SD=15,63$); dhe në fund ata që janë të papunësuar ($M=67,62$, $SD=14,82$). Vlera e $F(329)$ është 0,599 dhe $p=0,616$ që nënkupton se nuk ka dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale sipas statusit të punës. Hipoteza 7.1. refuzohet.

Në shkallën e ankthit social, mesatare më të lartë kanë arritur pjesëmarrësit të cilët janë të punësuar me orar të pjesshëm (part-time) me vlerë ($M=49,31$, $SD=10,68$); pastaj në rend të dytë studentët me mesatare ($M=47,47$, $SD=14,57$); në rend të tretë pjesëmarrësit që punojnë me orar të plotë ($M=46,96$, $SD=13,83$); dhe në fund pjesëmarrësit të cilët janë të papunësuar ($M=43,22$, $SD=14,24$). Sipas vlerës së $F(329)=1,268$ dhe $p=0,285$ konstatojmë se nuk kemi dallime sipas statusit të punës në shkallën e ankthit social. Sipas rezultatit të arritur, hipoteza 7.2. refuzohet.



Tabela 21. Të dhënat përshkruese sipas statusit të punës në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social.

	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error	F	Sig.
Varësia						
Full-time employee	51	69,5098	18,20700	2,54949		
Part-time employer	16	73,7500	10,80432	2,70108		
Unemployed	45	67,6222	14,82824	2,21046	,599	,616
Student	218	69,2248	15,63141	1,05869		
Total	330	69,2697	15,73614	,86625		
Ankthi						
Full-time employee	51	46,9608	13,83034	1,93664		
Part-time employer	16	49,3125	10,68157	2,67039		
Unemployed	45	43,2222	14,24125	2,12296	1,268	,285
Student	218	47,4725	14,57419	,98709		
Total	330	46,9030	14,27742	,78595		

Mesatare më të lartë në varësinë nga rrjetet sociale kanë arritur pjesëmarrësit që qëndrojnë mbi tetë orë brenda ditës ($M=79,90$, $SD=18,22$); pastaj pjesëmarrësit që në rrjete sociale qëndrojnë 7-8 orë me vlerë të mesatares ($M=78,50$, $SD=12,76$); të tretët vijnë ata me 5-6 orë qëndrim në rrjete sociale me mesatare ($M=74,14$, $SD=15,22$); të katërtit ata që qëndrojnë 3-4 orë ($M=68,71$, $SD=14,92$); dhe të fundit janë pjesëmarrësit që në rrjete sociale qëndrojnë 1-2 orë në ditë me vlerë të mesatares ($M=62,12$, $SD=15,11$). Sipas vlerës $F(329)=9,477$ dhe $p=0,000$ konstatojmë se ka dallime në varësinë nga rrjetet sociale sipas numrit të orëve që pjesëmarrësit i kalojnë në rrjete sociale brenda ditës. Hipoteza me numër 8.1. verifikohet.

Në shkallën e ankthit social, mesatare më të lartë kanë arritur pjesëmarrësit që në rrjete sociale qëndrojnë 7-8 orë brenda ditës ($M=53,79$, $SD=12,56$); pastaj në rend të dytë pjesëmarrësit që në rrjete sociale qëndrojnë 5-6 orë brenda ditës me vlerë të mesatares ($49,09$, $SD=15,95$); në rend të tretë pjesëmarrësit që qëndrojnë mbi tetë orë në rrjete sociale ($M=48,40$, $SD=14,60$); në rend të katërt ata që qëndrojnë 3-4 orë ($47,08$, $SD=14,25$); dhe të fundit pjesëmarrësit që qëndrojnë në rrjete sociale 1-2 orë brenda ditës ($42,32$, $SD=12,13$). Vlera e $F(329)=3,853$ dhe $p=0,004$ vërteton se ekzistojnë dallime statistikore në nivelin e ankthit social te pjesëmarrësit sipas numrit të orëve që ata qëndrojnë në rrjete sociale brenda ditës. Hipoteza numër 8.2. verifikohet.



Tabela 22. Të dhënat përshkruese sipas numrit të orëve që pjesëmarrësit qëndrojnë në rrjete sociale brenda ditës në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social.

	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error	F	Sig.	
Varësia	1-2 hours	75	62,1200	15,11305	1,74510	9,477	,000
	3-4 hours	160	68,7125	14,92513	1,17994		
	5-6 hours	61	74,1475	15,22152	1,94892		
	7-8 hours	24	78,5000	12,76544	2,60574		
	more than 8 hours	10	79,9000	18,22361	5,76281		
	Total	330	69,2697	15,73614	,86625		
Ankthi	1-2 hours	75	42,3200	12,13790	1,40156	3,853	,004
	3-4 hours	160	47,0875	14,25394	1,12687		
	5-6 hours	61	49,0984	15,95170	2,04241		
	7-8 hours	24	53,7917	12,56973	2,56579		
	more than 8 hours	10	48,4000	14,60746	4,61928		
	Total	330	46,9030	14,27742	,78595		

Në rend të parë, mesatare më të lartë në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale kanë arritur pjesëmarrësit të cilët përdorin smartfonë ($M=69,33$, $SD=15,47$); në rend të dytë përdoruesit e laptopit me mesatare ($M=69,00$, $SD=21,03$); dhe në fund përdoruesit e kompjuterit me mesatare ($M=67,00$, $SD=18,32$). Analiza statistikore e dallimit Anova me vlerë $p=0,916$ dhe $F(329)=0,088$ vërteton se këto dallime nuk kanë rëndësi statistikore. Kjo nënkupton se nuk ka dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale sipas mjetit elektronik që e përdorin pjesëmarrësit. Me këtë, hipoteza me numër 9.1. refuzohet.

Mesatare më të lartë në shkallën e ankthit social kanë arritur përdoruesit e smartfonëve me mesatare ($M=47,19$, $SD=14,26$); pastaj renditen pjesëmarrësit që janë përdorues të kompjuterëve me mesatare ($M=46,50$, $SD=11,83$); dhe të fundit renditen përdoruesit e laptopëve me mesatare ($M=40,23$, $SD=15,37$). Sipas Anovës $p=0,227$ dhe $F(329)=1,491$, konstatojmë se nuk kemi dallime në shkallën e ankthit social sipas mjetit elektronik që e përdorin pjesëmarrësit. Hipoteza me numër 9.2. refuzohet.



Tabela 23. Të dhënat përshkruese sipas mjetit elektronik që përdorin pjesëmarrësit në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social.

	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error	F	Sig.
Varësia Laptop computer	13	69,0000	21,03568	5,83425	,088	,916
Computer	8	67,0000	18,32251	6,47798		
Phone	309	69,3398	15,47572	,88038		
Total	330	69,2697	15,73614	,86625		
Ankthi Laptop computer	13	40,2308	15,37939	4,26548	1,491	,227
Computer	8	46,5000	11,83216	4,18330		
Phone	309	47,1942	14,26106	,81128		
Total	330	46,9030	14,27742	,78595		



IV. PËRFUNDIM

Ky studim është realizuar me metodologjinë e kërkimeve kuantitative (sasiore) dhe të dhënat i kemi mbledhur nëpërmjet pyetësorit. Mbledhja e të dhënave është bërë nëpërmjet internetit, duke e shpërndarë pyetësorin në grupe në WhatsApp, te popullacioni i cili ka qenë target i studimit tonë. Qëllimi kryesor është të verifikojë marrëdhënien në mes varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social. Në studim kanë marrë pjesë gjithësej 330 pjesëmarrës nga nëntë vende të ndryshme të Ballkanit. Prej tyre, 79 (23,9%) janë meshkuj dhe 251 (76,1%) femra. Pjesëmarrësit i kemi ndarë në katër grupmosha, ku nga rezultatet shohim se 48% e tyre janë mes moshës 16-18 vjeç, 35% i takojnë grupmoshës 18-24 vjeç, 12% janë të grupmoshës 24-30 vjeç dhe 5% janë mbi 30 vjeç. Sipas statusit martesor, numri më i madh i pjesëmarrësve janë beqarë (82%), afër 10% janë të martuar dhe 8% të fejuar. 52% e pjesëmarrësve janë nga Republika e Maqedonisë së Veriut, rreth 16% nga Shqipëria, rreth 12% janë nga Kosova, 10% nga Greqia dhe pjesa tjetër janë pjesëmarrësit nga Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Bullgaria dhe Serbia. Sa i përket nivelit të arsimimit, 54% e pjesëmarrësve kanë të kryer studimet diplomike dhe postdiplomike, më pas renditen pjesëmarrësit me shkollë të mesme me 42,4%, kurse pjesëmarrja më e ulët është e atyre me shkollë fillore me 3,6%. Në bazë të statusit të punës, 15% e pjesëmarrësve janë të punësuar me orar të plotë, 5% janë të punësuar me orar të pjesshëm, 12% janë të papunësuar dhe 68% janë studentë. 48,5% e pjesëmarrësve i përdorin rrjetet sociale 3-4 orë në ditë, 18,5% kanë deklaruar se rrjetet sociale i përdorin 5-6 orë në ditë, 23% 1-2 orë në ditë, 7% i përdorin rrjetet sociale 7-8 orë brenda një dite dhe 3% deklarojnë se janë përdorues mbi tetë orë të rrjeteve sociale brenda ditës. Nga mjetet elektronike më së shumti përdoren celularët ose smartfonët me 94%, pastaj laptopi me 4% dhe kompjuteri vetëm me 2%. Ndërkaq, rrjetet sociale që përdoren më së shumti nga pjesëmarrësit janë Instagrami, Whatsapp-i dhe Snapchat-i. Pyetësorët për varësinë nga rrjetet sociale dhe ankthin social kanë treguar nivel të lartë të besueshmërisë së brendshme.

Studimi i realizuar është një pilot-projekt të cilin mendojmë ta përsërisim çdo vit.

Të dhënat i kemi analizuar me paketën për përpunime statistikore SPSS.16. Gjatë analizave kemi marrë parasysh variablat demografike si gjinia, moshja, niveli i arsimimit, statusi martesor, statusi i punës, vendi i banimit, kohëzgjatja e qëndrimit në rrjete sociale, mjeti elektronik që e përdorin më së shumti si dhe përdorues të cilit rrjet social janë më së shumti. Nga analiza e të dhënave kemi ardhur në disa përfundime, si në vazhdim:



Mesatarja e arritur e varësisë nga rrjetet sociale dhe e ankthit social janë nën mesataret e tyre të pritura, që do të thotë kemi identifikuar nivel të ulët të varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te pjesëmarrësit e studimit.

- Ekziston marrëdhënie mesatare pozitive mes varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social ($r=0,447$, $p<0.01$), gjithashtu i rëndësishëm statistiki në nivel 0.01. Hipoteza kryesore verifikohet.

- Nuk ekzistojnë dallime të rëndësishme mes meshkujve dhe femrave në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social. Hipotezat 2.1. dhe 2.2. refuzohen.

- Nuk ekzistojnë dallime mes grupmoshave të ndryshme në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social. Me këtë, hipotezat 3.1. dhe 3.2. refuzohen.

- Ka dallime të rëndësishme statistike mes pjesëmarrësve të fejuar, martuar dhe beqarë në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale. Hipoteza 4.1. vërtetohet. Pjesëmarrësit e martuar kanë mesatare më të lartë të varësisë nga rrjetet sociale në krahasim me pjesëmarrësit beqarë dhe të fejuar. Ndërkaq në shkallën e ankthit social nuk ka dallime mes pjesëmarrësve sipas statusit të tyre social. Hipoteza 4.2. refuzohet.

- Nuk ka dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te pjesëmarrësit sipas vendit ku jetojnë. Hipotezat 5.1. dhe 5.2. refuzohen.

- Ka dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social sipas nivelit të arsimimit të pjesëmarrësve. Sipas rezultateve, pjesëmarrësit që kanë të kryer shkollën fillore janë më të varur nga rrjetet sociale dhe gjithashtu kanë nivel më të lartë të ankthit social në krahasim me pjesëmarrësit me shkollë të mesme, fakultet, magjistraturë dhe doktoratë. Hipotezat me numër 6.1. dhe 6.2. verifikohen.

- Nuk ka dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social te pjesëmarrësit sipas statusit të punës. Hipotezat 7.1. dhe 7.2. refuzohen.

- Ka dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social sipas numrit të orëve që pjesëmarrësit i kalojnë në rrjete sociale brenda ditës. Më konkretisht, mesatare më të lartë të varësisë nga rrjetet sociale kanë treguar pjesëmarrësit që qëndrojnë mbi tetë orë në rrjetet sociale brenda ditës, ndërkaq në shkallën e ankthit social mesatare më të lartë kanë arritur pjesëmarrësit që në rrjete sociale qëndrojnë 7-8 orë brenda ditës. Hipotezat me numër 8.1. dhe 8.2. verifikohen.

- Nuk ka dallime në shkallën e varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social sipas mjetit elektronik që e përdorin pjesëmarrësit. Me këtë, hipotezat me numër 9.1. dhe 9.2. refuzohen.



Të dhënat për përdorimin e rrjeteve sociale tregojnë vazhdimisht për rritje të përdoruesve të rrjeteve sociale. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë për nivel të ulët të varësisë nga rrjetet sociale dhe ankthit social, por ky fenomen duhet të jetë vazhdimisht çështje hulumtimi e studiuesve për shkak të ndikimit negativ që mund të ketë në shoqëri. Ky studim do të përsëritet çdo vit, kështu që ne do të kemi mundësi të bëjmë krahasime nga viti në vit dhe të shohim se si zhvillohet trendi i përdorimit të rrjeteve sociale (varësia nga rrjetet sociale dhe ankthi social). Kjo për shkak se zhvillimi i teknologjisë paraqet faktor thelbësor për aspektin ekonomik, social, kulturor, juridik, politik, rritjen e konsumerizmit (blerjet “online”) e deri te procesi edukativo-arsimor. Njëra ndër sfidat e paraqitura nga pandemia COVID-19 është edhe aplikimi i mësimit “online” në shkolla e universitete, ku nxënësit dhe studentët janë të imponuar të qëndrojnë kohë më të gjatë në mjete elektronike (telefon celular, laptop, kompjuter) sesa gjatë një periudhe normale ku mësimi zhvillohej me prezencë fizike.



V. LİTERATURA

1. Aslan T. (2020). *Üniversite öğrencilerinin sosyal medya kaygılarının sosyal medya bağımlılıklarını yordayıcı rolünün incelenmesi*, e-disponueshme në linkun më poshtë, Microsoft Word - TÛLAY ASLAN-5303929698 (cag.edu.tr), (10.09.2021).
2. Aktan E. (2018). *Sosyal medya ve sosyal kaygı: sosyal medya kullanıcıları üzerine bir araştırma*. Selçuk İletişim, 11 (2): 35-53.
3. Çomlekçi M. F. ve Başol O. (2019) *Gençlerin Sosyal Medya Kullanım Amaçları ile Sosyal Medya Bağımlılığı İlişkisinin İncelenmesi*. Celal Bayar Üniversitesi Sosyal Bilimler Dergisi.
4. Chunduru A.P. (2014). *Social Media Addiction*. DOI:10.13140/2.1.2578.9448.
5. Green T., Wilhelmsen T., Wilmots E. , Dodd B. , Quinn S. (2016). *Social anxiety, attributes of online communication and self-disclosure across private and public Facebook communication*. Computers in Human Behavior, Volume 58, Pages 206-213, <https://doi.org/10.1016/j.chb.2015.12.066>.
6. Inceoğlu Y. G. (2020). *Covid-19 Pandemisi ve Medya*. Ankara: Türk Tabipleri Birliği.
7. Jafari H., Dadipoor S., Haghighi H., Ghanbarnejad A., Zarei E., Moradabadi A. S., (2014). *The relationship between demographic variables and internet addiction among Medical university students in Bandar Abbas*. Life Science Journal.
8. Jefferies P, Ungar M (2020) *Social anxiety in young people: A prevalence study in seven countries*. PLoS ONE 15(9): e0239133.
9. Leventler M., Bakırçalı Ö ve Gönül E. (2020). *Covid-19 Virüsünün Dijital Medya ve Mobil Üzerindeki Etkisi*. İstanbul: MMA.
10. Ólafarson B.A. (2018). *Social Media Use and its Connection to Anxiety and Gender*.
11. Sayar K. (2019), Ağ, İstanbul.
12. Şentürk E., Geniş B., Menkü B. ve Cosar B. (2020). *Kullanıcıların güvendiği ve doğruladığı sosyal medya haberlerinin COVID-19 Pandemisinde kaygı düzeyi ve hastalık kontrol algısı üzerindeki etkileri*. Journal Agent.
13. Ünal A. T. (2016). *Sosyal Medya Bağımlılığı: Üniversite Öğrencileri üzerine bir Araştırma*. Route Educational and Social Science Journal.
14. Wakefield, L.t., & Wakefield, R.L. (2018). *Anxiety and Ephemeral Social Media Use in Negative Ewom Creation*. Journal of Interactive Marketing, 41, 44-59.
15. Şahin C. dhe Yagci M. (2017). *Sosyal Medya Bağımlılığı Ölçeği-Yetişkin Formu: Geçerlilik ve Güvenirlilik Çalışması Social*. Ahi Evran Üniversitesi Kırşehir Eğitim Fakültesi Dergisi (KEFAD), Cilt 18, Sayı 1, Sayfa 523-538.



IDEFE
PUBLICATIONS

www.idefe.net

